



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 197, Datë 19.06.2023

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1”
SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.06.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1756/4 prot., datë 16.06.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SPV BLUE 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1756 prot., datë 07.06.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “SPV BLUE 1” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmën “a” dhe pikën 2.5.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”**: Duhet të depozitohet në ERE vërtetimi i gjendjes gjyqësore lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vetë shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacion mbështetës të financimit të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike për të paktën 1 muaj.
 - **gërma “c”**: Plani i biznesit i depozituar i referohet vetëm veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaik “Blue 1”, por referuar kërkesave specifike të kësaj pike të rregullores shoqëria duhet të depozitojë në ERE planin e biznesit për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI